



Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/18 Nr. i faq./Br.str./No.pg 74

Data/Datum/Date 31/01/2025

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 21 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019"), nenit 5 paragrafi 1 pika 1.3, lidhur me nenin 24 dhe nenin 25 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë me Nr. Prot. 366 të datës 24.01.2025 dhe Nr. të brendshëm të Prot. 02/5199 të datës 24.01.2025, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur më datë: 31.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për rastet e veçanta

1. **Miratohet** vendimi për dhënien në shfrytëzim Ministrisë së Ekonomisë pronat e paluajtshme të Komunës së Rahovecit.
2. Pronat e paluajtshme të dhëna në shfrytëzim sipas pikës 1 të këtij vendimi janë:
 - 2.1. Pjesën e parcelës sipas certifikatës së pronësisë P-71510039-00760-1 në Zonën Kadastrale Kramovik në sipërfaqe prej 2168m² (dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë metra katror) e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 9470m² (nëntë mijë e katërqind e shtatëdhjetë metra katror) e evidentuar në emër të: PRONË SHOQËRORE-RRUGËT;K.K.RAHOVEC;
 - 2.2. Pjesën e parcelës sipas certifikatës së pronësisë P-71510039-00500-5 në sipërfaqe prej 255m² (dyqind e pesëdhjetë e pesë metra katror) dhe 471m² (katërqind e shtatëdhjetë e një metra katror) të cilat ndahen nga sipërfaqja e përgjithshme prej 800m² (tetëqind metra katror) e evidentuar në emër të: PRONË SHOQËRORE-RRUGËT;K.K.RAHOVEC;
 - 2.3. Pjesën e parcelës sipas certifikatës së pronësisë P-71510061-01124-2 në Zonën Kadastrale Petkoviq në sipërfaqe prej 4225m² (katër mijë e dyqind e njëzet e pesë metra katror) e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 4320m² (katër mijë e treqind e njëzet metra katror) e evidentuar në emër të: P.SH.E KOSOV.K.K.RAHOVC-RRUGËT;
 - 2.4. Parcelën sipas certifikatës së pronësisë P-71510061-00185-0 në Zonën Kadastrale Petkoviq në sipërfaqe prej 550m² (pesëqind e pesëdhjetë metra katror) e evidentuar në emër të: P.SH.E KOSOV.K.K.RAHOVC-RRUGËT;
 - 2.5. Pjesën e parcelës sipas certifikatës së pronësisë P-71510061-01122-0 në Zonën Kadastrale Petkoviq në sipërfaqe prej 2990m² (dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë metra katror) e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 19777m² (nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë metra katror) e evidentuar në emër të: P.SH.E KOSOV.K.K.RAHOVC-RRUGËT;

- 2.6. Pjesët e parcelave sipas certifikatës së pronësisë P-71510061-01124-1 në Zonën Kadastrale Petkoviq në sipërfaqe prej 975m² (nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë metra katror) dhe 5253m² (pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë e tre metra katror) të cilat ndahen nga sipërfaqja e përgjithshme prej 23199m² (njëzet e tre mijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë metra katror) e evidentuar në emër të P.SH.E KOSOV.K.K.RAHOVC-RRUGËT.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronave të paluajtshme të Komunës, të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi bëhet për ndërtimin e centralit fotovoltaiik me kapacitet 100MW nga “Lindja Solar L.L.C.”.
 4. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës, të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatgjatë dhe atë për periudhën 34 (tridhjetë e katër) - vjeçare.
 5. Prona e paluajtshme sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi i jepet Ministrisë së Ekonomisë, me kompensim prej 2028.00 € (dymijë e njëzet e tetë euro) në vit.
 6. Pronat e paluajtshme në fjalë nuk e ndërrojnë titullarin juridik, pronar i tyre mbetet Kuvendi i Komunës së Rahovecit, të njëjtat nuk mund të tjetërsohen, nuk mund të jenë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këto prona.
 7. Autorizohet Kryetari i Komunës që të përcaktojë me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe Ministrisë së Ekonomisë.
 8. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që të bëjë evidentimin në librat kadastralë të komunës, pronat e paluajtshme të dhëna në shfrytëzim për rastet e veçanta sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi.
 9. Procedura për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme në pronësi të Komunës, u realizua duke u bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019”) dhe nenin 24 dhe 25 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
 10. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *Ministrisë së Ekonomisë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.08/25
Më datë:31.01.2025

